



Mae Brechu yn achub bywydau Vaksinimi shpeton jete

Çfarë duhet të prisni pasi të bëni vaksinën COVID-19

Vaksina COVID-19 që keni marrë është ndër të parat, që aprovohet si e sigurt dhe efektive nga Agjencia e Rregullimit të Pavarur të Barnave dhe Produkteve Shëndetësore (MHRA). Çdo vaksinë është testuar në rreth 20,000 njerëz në disa vende të ndryshme dhe ka rezultuar e sigurt. Më poshtë janë disa nga efektet anësore që mund të përjetoni.

Cilat janë efektet anësore të mundshme?

Si të gjitha ilaçet, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Këto janë zakonisht të lehta dhe zgjasin vetëm disa ditë, dhe jo të gjithë mund ti kenë.

Efektet anësore më të zakonshme përfshijnë:

- pasja e një dhimbje dhe ndjeshmërie në krah, pas injektimit, për disa ditë pas vaksinës
- ndjen lodhje
- dhimbje koke
- dhimbje të përgjithshme, ose simptoma të lehta si gripi

Mund të këni pak temperaturë për dy deri në tre ditë, por një temperaturë e lartë është e pazakontë dhe mund të tregojë se keni COVID-19 ose një infeksion tjetër. Ju mund të merrni dozën normale të paracetamolit (siç këshillohet në paketim) dhe pushoni që të ndiheni më mirë. Mos e tejkaloni dozën normale. Një efekt anësor i pazakontë është ënjtja e gjëndrave lokale.

Rrallë, disa njerëz kanë një reaksion alergjik menjëherë pas një vaksinimi. Kjo mund të jetë një skuqje ose kruarje që prek një pjesë ose të gjithë trupin. Akoma më rrallë, disa njerëz mund të kenë një reagim të ashpër, menjëherë pas vaksinimit, që shkakton

probleme me frymëmarrjen dhe mund të humbasë ndjenjat.

Kjo quhet anafilaksi dhe mund të ndodhë me ilaçe dhe ushqime të tjera. Këto reagime janë të rralla dhe infermierët janë të trajnuar për t'i menaxhuar ato. Njerëzit të cilët kanë një reaksion anafilaktik mund të trajtohen me sukses dhe zakonisht shërohen brenda disa orësh.

Simptomat pas vaksinimit normalisht zgjasin më pak se një javë.

Nëse simptomat tuaja duket se përkeqësohen ose nëse shqetësoheni, vizitoni <https://111.wales.nhs.uk>, dhe nëse është e nevojshme telefononi NHS Uells në 111 ose GP tuaj. Nëse 111 nuk është i disponueshëm në zonën tuaj, telefononi në 0845 46 47. Telefonatat në NHS 111 Uells janë falas nga telefonat fiks dhe celularë. Telefonatat në 0845 46 47 kushtojnë 2p për minutë plus tarifën e zakonshme të kompanisë tuaj të telefonit.

Nëse kërkoni këshillë nga një mjek ose infermier, sigurohuni që t'i tregoni për vaksinimin tuaj (tregojini kartën e vaksinimit) në mënyrë që ata të ju vlerësojnë si duhet.

Ju mund të raportoni çdo efekt anësor në internet në: coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk ose përmes aplikacionit Card Yellow.

Çfarë të bëj më pas?

Planifikoni të merrni pjesë në takimin tuaj të dytë. Ju duhet të keni një kartë regjistrimi me takimin tuaj të radhës. Është e rëndësishme që të keni të dyja dozat e vaksinës për t'ju dhënë mbrojtjen më të mirë. Mos harroni të merrni kartën tuaj në takimin tjetër.

Çfarë duhet të bëj nëse nuk jam mirë kur është takimi im i radhës?

Nëse nuk ndiheni mirë dhe keni temperaturë, është më mirë të prisni derisa të shëroheni për të bërë vaksinën, telefononi për të lënë një takim tjetër dhe përpiquni ta bëni sa më shpejt të jetë e mundur. Ju gjithashtu nuk duhet të merrni pjesë në takim për vaksinën dhe duhet të telefononi për të lënë një takim tjetër, nëse jeni vetëizoluar, ose jeni duke pritur për një test ose rezultat të COVID-19.

A do të më mbrojtë vaksina?

Vaksinimi COVID-19 do të zvogëlojë mundësinë që të merrni sëmundjen COVID-19. Mund të duhen disa javë që trupi juaj të krijojë mbrojtje nga vaksina. Ashtu si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është 100% efektive, kështu që ju duhet të vazhdoni të merrni masat paraprake të rekomanduara si distancimi social, higjiena e duarve dhe maskat e fytyrës për të shmangur infeksionin. Disa njerëz mund të marrin ende COVID-19 pasi të kenë bërë një vaksinë, por kjo duhet të jetë më pak e rëndë.

A mund t'ia jap dikujt COVID-19, tani që kam bërë vaksinën?

Vaksina nuk mund t'ju japë infeksion COVID-19. Dy doza do të zvogëlojnë

mundësinë për tu sëmurë rëndë. Ne ende nuk e dimë nëse kjo do t'ju ndalojë të kapni dhe përçoni virusin. Pra, akoma është e rëndësishme të ndiqni udhëzimet në zonën tuaj lokale, për të mbrojtur ata që ju rrethojnë. Informacioni mund të gjendet në <https://gov.wales/coronavirus>.


Tre rregulla të MABJME UELLSIN TE SIGURT



Lani
Duart



Mbani
maske



Mbani
2m distance

© Shëndeti Publik i Uellsit, Dhjetor 2020
(I njohur nga Shëndeti Publik i Anglisë)

ISBN 978-1-78986-154-237